



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 211 Akti

Nr. 279 Vendimi
Tiranë, më 23.7.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 21 korrik 2020, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:	Znj. Flutura Skënderi , gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
OBJEKTI:	Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.
BAZA LIGJORE:	Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 84/2016 , “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 44/2015 , “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 49/2012 , “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Lulzim Hamitaj, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi në tërësi çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit, znj. Flutura Skënderi, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 21.7.2020, kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Flutura Skënderi, për shkak të funksionit si gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016¹.
2. Pas hedhjes së shortit, trupi gjykues nr. 1 – i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Lulzim Hamitaj dhe Pamela Qirko – pasi administroi dhe studioi raportet e institucioneve të parashikuara nga nenet 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktojë kryesues të trupit gjykues, znj. Pamela Qirko. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
3. Në vijim të hapave hetimorë të ndërmarrë nga Komisioni në datën 11.3.2020, me vendimin nr. 2, trupi gjykues vendosi të mbyllë fazën hetimore dhe në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për znj. Flutura Skënderi të bazohet në të tria kriteret e rivlerësimit dhe përkatësisht: rivlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin profesional.
4. Në datën 12.3.2020, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda datës 25.10.2019; (iii) për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative.
5. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit për t'u njohur me dosjen, por ka paraqitur shpjegimet dhe parashtrimet në Komision. Pas pezullimit të afatit për shkak të pandemisë, COVID-19, në datën 19.5.2020 Komisioni e njoftoi subjektin për rinisjen e afatit për të paraqitur shpjegimet dhe provat. Në datën 3.6.2020, znj. Flutura Skënderi paraqiti prapësimet e saj të shoqëruara me dokumentacion mbështetës voluminoz.
6. Në datën 14.7.2020, Komisioni e ka njoftuar subjektin, në rrugë elektronike, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me seancën dëgjimore të caktuar për në datën

¹ Paragrafi 3 i nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim referuar si ligji nr. 84/2016) parashikojnë se: "Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*".

21.7.2020, datë në të cilën seanca u zhvillua rregullisht, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent dhe paraqiti shpjegimet dhe argumentimet e saj.

II. SEANCA DËGJIMORE

7. Seanca dëgjimore e datës 21.7.2020 – për subjektin e rivlerësimit, znj. Flutura Skënderi – u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016 në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma.
8. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit – dhe të kaluara si barrë prove, apo për shpjegime.
9. Znj. Flutura Skënderi, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke e vlerësuar objektiv hetimin administrativ të Komisionit.
10. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës dëgjimore, iu përgjigj pyetjeve të bëra nga trupi gjykues, shprehu qëndrimin përfundimtar të argumentuar dhe në konkluzion kërkoi konfirmimin në detyrë.
11. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Flutura Skënderi, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit.
12. Seanca dëgjimore e datës 21.7.2020 u ndërpre, për të rifilluar në datën 23.7.2020, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

13. Znj. Flutura Skënderi ka mbajtur një qëndrim bashkëpunues me Komisionin, duke dhënë përgjigje sa herë është pyetur, si dhe ka paraqitur dokumentacion mbështetës për shpjegimet e saj edhe në lidhje me burimet financiare të personave të tjerë me të cilët kishte pasur marrëdhënie financiare.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:
 - i. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, Vetting”;
 - ii. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
 - iii. raportet dhe informacionet mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
 - iv. provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
 - v. deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik me Komisionin;

- vi. shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, si dhe argumentimeve të bëra nga subjekti në seancën dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit;
- vii. deklaratimet e personave të lidhur, apo të tjerë të lidhur;
- viii. faktet e njohura botërisht.

A. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË

15. ILDKPKI-ja, bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Flutura Skënderi, ku konstatohet se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin,*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

16. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

17. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; si dhe evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave parashikuar në pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

18. Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për rivlerësim kalimtar, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, janë si më poshtë:

- i. **tokë truall me sip. 225 m²** në bashkëpronësi të trashëgimtarëve (A. dhe M. R.)², nga shkëmbimi i saj është përfiturar një sipërfaqe ndërtimore me sip. 57 m², të cilës i është shtuar edhe një sipërfaqe ndërtimore shtesë prej 50 m² e blerë nga ndërtuesi;
- ii. **autoveturë tip “Mercedez – Benz”, targa *****, prodhim i vitit 1995, blerë në vlerën 8.000 euro;
- iii. **gjendje cash³ në vlerën 10.000 euro⁴**;
- iv. **llogari rrjedhëse e pagës** në “Credins Bank”, me gjendje 4.909 lekë dhe llogari rrjedhëse e pagës në “Raiffeisen Bank” me gjendje 0 (zero) lekë;
- v. **kredi bankare në “Alpha Bank”** në vlerën 4.000.000 lekë⁵;

² Pasuria truall, njohur dhe kthyer me vendimin nr. ***, datë 15.12.1995, të AKKP-së, në dosje rezulton se numri i vendimit të AKKP-së është gabim.

³ Deklaron në deklaratën “Vetting”, gjendje *cash* në familje.

⁴ Burimi i krijimit nga të ardhurat në familje.

⁵ Mbetur pa u shlyer në momentin e deklarimit vlera prej 1.278.996,87 lekësh.

- vi. **tokë truall me sip. 3200 m²** në Korçë, në bashkëpronësi me 10/27 pjesë, të bashkëshortit të subjektit.

Vlerësimi i pasurisë

1. Tokë truall me sip. 225 m², në bashkëpronësi të trashëgimtarëve të familjes R. me pjesë takuese 1/20

19. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën periodike të vitit 2003 me sip. 180 m² ⁶, përfituar nga trashëgimia me vendimin nr. ***, datë 15.12.1994, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave⁷, ndërsa në deklaratën “Vetting” sipërfaqja e deklaruar është 225 m², njohur, kthyer dhe kompensuar⁸.
20. Burimi i krijimit është deklaruar në deklaratën vjetore të pasurisë së vitit 2003 sipas vendimit nr. ***, datë 15.12.1994, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.
21. Me shkresën nr. *** prot., datë 1.2.2018, ZQRPP-ja Tiranë ka konfirmuar se znj. Flutura Skënderi ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurinë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, lloji truall me sip. 120 m² në bashkëpronësi⁹. Bashkëlidhur është përcjellë dokumentacioni, si vijon:
- pasuri e transkriptuar nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, lloji i pasurisë, apartament me sip. 56 m²¹⁰;
 - kartelë pasurie me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 120 m² truall, në emër të bashkëpronarëve F. dhe F. R. etj., lëshuar në datën 31.1.2018;
 - kontratë e pjesëtimit vullnetar me nr. ***, datë 27.6.2001, ku cilësohet se trashëgimtarët F. R. dhe të tjerë do të kenë në bashkëpronësi truall të lirë prej 120 m² dhe të drejtën për t’u kompensuar për truallin prej 100 m², të zënë nga ndërtimi.
22. Gjithashtu, lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin e mëposhtëm:
- vendimin nr. ***, datë 15.12.1995, të AKKP-së “Për njohjen pronarë të truallit të lirë të trashëgimtarëve A. R. dhe M. R.”;
 - shkresën nr. ***, datë 30.4.2015, të AKKP-së, bashkëlidhur vendimi nr. ***, datë 30.4.2015, për kompensimin në të holla të sip. 100 m², në vlerën 5.172.600 lekë¹¹;
 - shkresën nr. *** prot., datë 3.9.2019, të ASHK-së Tiranë, ku bëhet me dije se subjekti Flutura Skënderi ka të regjistruar pasurinë e paluajtshme me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, lloji i pasurisë truall me sip. 120 m², në bashkëpronësi me të tjerë.

⁶ Referojuni faqes nr. 4 të DVP-së së vitit 2003, deklaruar sip. 180 m² truall, pjesa që zotëron 1/20.

⁷ Rezulton se vendimi me nr. ***, datë 15.12.1994, i KKKP-së është të njohë A. R. dhe M. R. (dhe trashëgimtarët e tyre) për 1/3 secili, duke i njohur dhe kthyer pronësinë e truallit të lirë me sip. 178 m², si dhe kompensimin për truallin e zënë me sip. prej 100 m², njihet dhe kthehet për truallin me sip. 47 m², të zënë me objekte të përkohshme, i njihet dhe kthehet pronësia për truallin e dyqanit dhe të magazinës me sip. prej 63 m².

⁸ Në sipërfaqen e kthyer në bashkëpronësi me vendimin e AKKP-së, për sipërfaqen 120 m² është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 16.2.2009, nga ku është përfituar banesa me sipërfaqe 107 m², nga e cila 57 m², është përfituar nga trashëgimia dhe 50 m² është blerë me çmimin 800 euro/m², me vlerë 40.000 euro.

⁹ Viti i lindjes në kontratën e pjesëtimit nuk përputhet me informacionin e shkresës.

¹⁰ Nuk rezulton të ketë faqe të dytë të shkresës.

¹¹ Në faqen 2, të vendimit të KKP-së, pika 6 cakton se: sipas kontratës së pjesëtimit vullnetar, bashkëpronarët F. dhe Y. R. dhe të tjerë, do të kenë në bashkëpronësi një truall të lirë prej 120 m² dhe të drejtën për t’u kompensuar për truall prej 100 m². Gjithashtu, rezulton se në pikën 10, znj. F. R. (ka gabim mbiemrin) emërojnë si përfaqësues të tyre me prokurën e posaçme nr. ***, datë 29.1.2015, z. E. R. për të tërhequr vlerën financiare të kompensimit.

23. Lidhur me sipërfaqen e këtij trualli, Komisioni ka konstatuar disa pasaktësi, si më poshtë:
- në deklaratën “Vetting” ka deklaruar se është bashkëpronare e sipërfaqes tokë truall të njohur me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në sipërfaqen prej 225 m² me pjesë takuese 50 %;
 - në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 ka deklaruar se është bashkëpronare e sipërfaqes prej 180 m² me pjesë takuese 1/20.
24. Në këto kushte, Komisioni i ka drejtuar një pyetje subjektit të rivlerësimit, lidhur me pasaktësinë e sipërfaqes dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 27.9.2019, ka sqaruar se: *“Sipërfaqja e lirë 178 m² nuk i është nënshtruar pjesëtimit, por e pandarë i është venë në dispozicion, në vitin 2004, sipërmarrësit shoqërisë së ndërtimit ‘***’ sh.p.k., më pas kjo marrëdhënie ka ndryshuar dhe ka kaluar tek shoqëria ndërtuese ‘***’ sh.p.k., duke u tjetërsuar tashmë në send të përfutur nga pronarët e truallit, sipas kontratave të sipërmarrjes”.*
25. Trupi gjykues çmon se lidhur me këtë pasuri janë konstatuar pasaktësi të diktuar nga dinamika evoluese e pjesëtimit, regjistrimit dhe tjetërsimit të saj, të cilat nuk mbartin në vetvete efekte të një peshe specifike të mjaftueshme për të passjellë përgjegjësi direkte të subjektit të rivlerësimit.

2. Apartament banimi në “*”, Tiranë,** me sipërfaqe të përbërë nga bashkëngjitja e 57 m² që janë përfutur nga shkëmbimi me truallin e trajtuar në pasurinë e mësipërme (nr. I), me 50 m² sipërfaqe ndërtimore shtesë, të blerë nga shoqëria ndërtuese, me çmimin e përcaktuar prej 40.000 euro.

26. Lidhur me këtë pasuri Komisioni ka administruar dokumentacionin, si vijon:
- kontratë sipërmarrje ndërmjet pronarëve të truallit me nr. ***, datë 16.2.2009, lidhur ndërmjet pronarit të truallit znj. Flutura Skënderi dhe sipërmarrësit të shoqërisë ndërtuese “***” sh.p.k.;
 - në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pronësinë e apartamentit në fjalë, duke specifikuar se një pjesë ishte përfutur nga shkëmbimi i pasurisë truall dhe ka blerë edhe një shtesë prej 50 m² në vlerën prej 40.000 euro, nga të cilat ka paguar 20.000 euro, si dhe i detyrohet shoqërisë së ndërtimit pjesën e mbetur, por pa përshkruar vlerën e këtij detyrimi;
 - lidhur me pagesat për shtesën prej 50 m² të apartamentit është administruar mandat-arkëtimi nr. 28, datë 21.11.2006, në vlerën 20.000 euro¹², arkëtuar nga znj. Flutura R.¹³;
 - rezulton se apartamenti në “***”, Tiranë është ende i paregjistruar në ZVRPP-në Tiranë, në kohën e deklarimit;
 - kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me nr. ***, datë 28.7.2006, për apartament me sipërfaqe 56 m², nr. ***, z. k. ***, vol. *** f. ***, me palë shitëse Dh. dhe Flutura Skënderi dhe me palë blerëse Sh. K., me vlerë 5.000.000 lekë¹⁴;

¹² Referuar deklaratës “Vetting” deklarohet se është paguar shuma prej 20.000 euro, sipas mandatpagesës nr. ***, datë 21.6.2006 dhe se kjo vlerë është përfutur nga shitja e banesës në bashkëpronësi me bashkëshortin) shuma është përdorur për blerjen e sipërfaqes së banimit 50 m², por nuk rezulton të jetë deklaruar pagesa prej 20.000 euro në DPV-në e vitit 2006. Kursi i këmbimit i Bankës së Shqipërisë, datë 21.6.2006, është 122.79 lekë dhe në datën 21.11.2006 është 123.86 lekë.

¹³ R. është mbiemri i vajzërisë i subjektit të rivlerësimit.

¹⁴ Shitja e pasurisë së paluajtshme të apartamentit është deklaruar në DPV-në e vitit 2006 dhe në deklaratën “Vetting”, por jo në rubrikën specifike të të ardhurave.

f. kartela e pasurisë së paluajtshme me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, shitur Sh. Xh. K., me vlerën prej 5.000.000 lekësh.

Lidhur me burimin e ligjshëm të të adhurave përdorur për blerjen e pjesës shtesë të kësaj pasurie me sip. 50 m², Komisioni ka konstatuar, si vijon:

27. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën “Vetting”, ka deklaruar si burim vlerën prej 5.000.000 lekësh, të përfituar nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sip. 56 m², sipas kontratës së shitjes së datës 28.7.2006¹⁵, ndërsa në deklaratën vjetore të pasurisë të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në rubrikën përkatëse vlerën prej 5.000.000 lekësh si të ardhur të përfituara nga shitja e banesës.
28. Ndërkohë, nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer pagesën prej 20.000 euro në datën 21.11.2006, shpenzim i cili është kryer me pjesën e mbetur të shumës prej 5.000.000 lekësh, për sa kohë – sipas subjektit – një pjesë e çmimit të shitjes, saktësisht shuma prej 1.800.000 lekësh është përfituar si paradhënie në vitin 2005 dhe është përdorur për shlyerjen e një kredie bankare.
29. Në deklaratën vjetore të pasurisë të vitit 2006 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në rubrikën përkatëse lidhur me detyrimet financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë, detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., dhe as pagesën e kryer në atë vit, prej 20.000 euro në favor të kësaj shoqërie.
30. Komisioni ka pyetur subjektin lidhur me mosdeklarimin e kësaj pagese dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti është shprehur se:

*“Nuk është deklaruar pagesa prej 20.000 euro apo detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese ‘***’ shpk, pasi veprimi juridik i kontratës së sipërmarrjes ende nuk ishte formalizuar në atë kohë”. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “Mungesa e deklarimit të detyrimit ndaj shoqërisë ndërtuese ‘****’ sh.p.k., ka ndodhur për shkak se punimet e brendshme nuk po kryheshin dhe është renë dakord verbalisht me shoqërinë sipërmarrëse ‘***’ sh.p.k., që punimet të kryheshin me shpenzimet e subjektit, punimet (e brendshme) të cilat do të mbulonin shumën e detyrimit të pashlyer (20.000 euro)¹⁶. Pagesa prej 20.000 euro është paguar me mandatpagesën datë 28.6.2006, subjektit ‘***’ sh.p.k., dhe kjo shumë është përfituar, nga pagesa e kësaj të detyrimit nga shitja e shtëpisë në bashkëpronësi me bashkëshortin”.*

31. Gjithashtu, lidhur me shitjen e apartamentit në bashkëpronësi me bashkëshortin, Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit në pyetësorin nr. 2, datë 23.9.2019, në përgjigje të të cilit ka shpjeguar se: *“Në muajin qershor 2005, është rënë dakord verbalisht me blerësit se çmimi i shitjes prej 5.000.000 lekësh do të paguhej me këste, si dhe kryerja e aktit të shitjes do të bëhej pasi të ishte shlyer e gjithë shuma e shitjes së apartamentit. Nga fillimi i muajit korrik (datën nuk e kujtoj), kam marrë shumën prej 1.800.000 lekësh¹⁷, si pjesë të çmimit*

¹⁵ Shitja e pasurisë së paluajtshme të apartamentit është deklaruar në DPV-në e vitit 2006 dhe në deklaratën “Vetting”, e cila ka shërbyer për shlyerjen e vlerës prej 20.000 euro.

¹⁶Subjekti sqaron se për kryerjen e punimeve të brendshme dhe për mobilimin e apartamentit ka marrë një kredi në shumën 885.003,70 lekë në vitin 2008 dhe një kredi në shumën 4.000.000 lekë në vitin 2009.

¹⁷ Është konsideruar dhe analiza alternative sipas deklarimit të subjektit në pyetësor për përfitimin e çmimit të shitjes me këste në vitet 2005 dhe 2006, dhe bilanci ka rezultuar me të njëjtën balancë negative, duke u përmirësuar situata në vitin 2005 me një bilanc negativ në vlerën 190.769 lekë dhe duke u përkeqësuar situata në vitin 2006 me një bilanc negativ në vlerën 2.562.935 lekë. Bilanci negativ i këtyre 2 viteve, në të dy rastet, është negativ në shumën 2.753.705 lekë.

(5.000.000 lekë). Në datën 11.8.2005, me shumën prej 1.800.000 lekësh (marrë nga premtim shitja e banesës), plus 100.000 lekë kursime familjare, kemi mbyllur kontratën e kredisë me 'Alpha Bank' në shumën 16.004 euro”.

32. Lidhur me pohimet e mësipërme të përfitimit të një kësti paraprak në vitin 2005 (si pjesë përbërëse e çmimit prej 5.000.000 lekë) ka rezultuar se në deklaratën pasurisë të vitit 2005 nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit e ardhura financiare e realizuar nga marrja e këstit të parë, në shumën prej 1.800.000 lekësh dhe as nuk është deklaruar zotërimi i gjendjes *cash*, në fund të vitit 2005.
33. Në deklaratën e pasurisë për vitin 2007 subjekti ka përshkruar se me vendimin nr. ***, datë 15.12.2004, të KKKP-së ka përfituar një sipërfaqe toke prej 225 m² në pronësi dhe me objekt shkëmbimi këtë pasuri, është realizuar kontrata e sipërmarrjes, ku në bazë të përqindjes përkatëse (40%) do të përfitohej një apartament me sip. 72 m², si dhe do të blihej një sipërfaqe shtesë prej 50 m². Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të ketë kryer ndonjë marrëveshje, si dhe nuk rezulton të ketë pasur ndonjë marrëdhënie kontraktore të formalizuara në këtë vit, me shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k. Në deklaratën e vitit 2008, subjekti ka deklaruar se ka kryer pagesën për sipërfaqen shtesë, sipas kontratës së sipërmarrjes, por nuk ka specifikuar shumën e paguar apo detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese, si dhe burimin e krijimit. Kjo pagesë ka rezultuar se ishte kryer shumë më herët, në vitin 2006. Në deklaratën e vitit 2009 subjekti ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “****” sh.p.k., me nr. ***, datë 16.2.2009, me anë të të cilës do të përfitohej një apartament me sip. 120 m².
34. Bazuar në të dhënat e përshkruara më sipër, Komisioni i ka njoftuar subjektin rezultatat e hetimit administrativ, e cila ka paraqitur prapësimet që përmbanin dhe mbështeteshin kryesisht tek argumentet që subjekti kishte paraqitur edhe më herët, nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorëve, duke shtuar dhe specifikuar se përfitimi i shumës prej 1.800.000 lekësh, *cash* nuk gjendet në deklaratën e vitit 2005 sepse ky veprim është formalizuar ligjërisht (shtatë muaj më pas) në datën 4.3.2006. Kjo ka qenë dhe arsyeja që veprimin e shitjes së kësaj banese subjekti e ka pasqyruar në deklaratën e vitit 2006. Gjithashtu, ky detyrim nuk është deklaruar në deklaratën “Vetting”, pasi ka qenë detyrim i përfunduar, pra, jo ekzistues.
35. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. *** rep., datë 4.3.2006, të lëshuar nga subjekti, bashkëshorti dhe shtetasi B. E., në të cilën kanë deklaruar se: “[...] Pronën kemi vendosur t’ia shesim z. B. E. në vlerën 5.000.000 lekë dhe sot në datën e nënshkrimit të deklaratës, ne Dh. dhe F. S. morëm në dorëzim nga B. E. shumën prej 1.800.000 lekësh [...]”. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe një tjetër deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 28.7.2006, të lëshuar nga subjekti, bashkëshorti dhe shtetasi Sh. K., në të cilën kanë deklaruar se: “[...] Apartamentin ia kemi shitur z. Sh. K. dhe se këtë apartament do t’ia lirojmë në momentin e përfundimit të apartamentit që kemi porositur pranë shoqërisë “****” sh.p.k. [...]”.
36. Lidhur me deklaratën e paraqitur nga shtetasi B. E., nuk rezulton të jetë sjellë dokumentacion që të tregojë lidhjen e tij me palën blerëse, z. Sh. K. – që rezulton formalisht në kontratën përfundimtare. Megjithatë, nën këndvështrimin financiar, mungesa burimeve

financiare që është konstatuar për vitet 2005 dhe 2006, të marra së bashku, nuk do të ndryshonte në totalin e vet, pasi edhe nëse nga Komisioni do të konsiderohej i besueshëm versioni se vlera prej 1.800.000 lekësh është përfituar dhe është përdorur nga subjekti në vitin 2005 dhe vetëm diferenca e mbetur nga çmimi prej 5.000.000 lekësh është likuiduar në vitin 2006, do të rezultonte e njëjta balancë negative e viteve së bashku, sepse duke u përmirësuar situata financiare në vitin 2005 në vlerën – 190.809 lekë automatikisht kjo do të reflektonte një përkeqësim në vitin 2006 në vlerën – 2.562.642 lekë. Pra, totali i bilancit negativ dyvjeçar do të ishte i njëjtë në të dy variantet.

Varianti I: Sipas përmbajtjes së kontratës dhe dokumentacionit të administruar.

Viti	2005	2006
Analiza dokumentuar	-1 990 769	-762 935

Varianti II: Nëse shuma 1,800,000 Lekë do të konsiderohej si e përfituar në vitin 2005.

Viti	2005	2006
Analiza dokumentuar	-190 769	-2 562 935

37. Në këto kushte, lidhur me sa është analizuar më sipër, trupi gjykues konstaton kryerjen e disa deklaramëve të pamjaftueshme lidhur me interesat pasurore dhe veprimet juridiko-financiare të subjektit të rivlerësimit, të cilat në konkluzion do të vlerësohen nën një këndvështrim tërësor të çështjes, për të çmuar efektet që passjellin, në raport me peshën e tyre specifike, në kuptimin sasior dhe cilësor të paplotshmërive dhe pasaktësive të deklaratave në fjalë. Gjithashtu edhe problematikat që lidhen me mungesën e burimeve financiare të ligjshme për këtë pasuri, do të trajtohen në paragrafin e analizës financiare, ku mundësohet një vlerësim i përgjithshëm i këtij aspekti, nëpërmjet ndërthurjes së të gjitha gjetjeve që lidhen me burimet financiare për çdo vit të analizuar.

Lidhur me detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese “**” sh.p.k.**

38. Shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k., nëpërmjet administratorit në atë periudhë, ka pohuar se: *“Në vitin 2008, porositesja e kishte të domosdoshme banimin në banesë dhe ishte rënë dakord që të përfundonte me shpenzimet e veta të gjitha punimet e brendshme, duke rënë në konsensus të shuarjes së detyrimit ndaj sipërmarrësit, për vlerën që do të paguhej në momentin e regjistrimit në ZVRPP-ja”.*
39. Ndërsa në konstatimet e ILDKPKI-së citohet se: *“Lidhur me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 16.2.2009, në vlerë totale 40.000 euro, subjekti ka likuiduar në vitin 2006, shumën prej 20.000 euro, kurse pjesën e mbetur prej 20.000 euro, të cilën ia kishte detyrim firmës e ka përmbushur, duke i kryer vet punimet e rifiniturës (me burim kredinë e marrë në vitin 2009). Rrjedhimisht detyrimi ndaj firmës është shlyer”.*
40. Në vijim, shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k., ka sqaruar se: *“Porositesja Flutura Skënderi, ka kryer pagimin e vlerës 20.000 euro sipas mandatpagesës dhe nuk ka asnjë detyrim tjetër për shkak të marrëveshjes verbale me sipërmarrësin”.* Por nga ana tjetër, Komisioni konstaton se në deklaratat e pasurisë për vitet 2008 dhe 2009, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar asnjë shpenzim lidhur me punimet e brendshme, që pretendohen si të kryera

pikërisht në këto dy vite. Ndërsa, në faqen 5 të deklaratës “Vetting”, subjekti duke deklaruar pronësinë e apartamentit në fjalë, ka specifikuar se një pjesë e tij (prej 57 m²) ishte përfituar nga shkëmbimi me pasurisë truall të përdorur për ndërtimin e objektit dhe se, ka blerë edhe një sipërfaqe ndërtimore shtesë prej 50 m² nga shoqëria ndërtuese “***” sh.p.k. me një çmim prej 40.000 euro, nga të cilat 20.000 euro janë paguar në vitin 2006 dhe diferenca prej 20.000 euro ka mbetur si një detyrim ende i pa shlyer – në datën 26.1.2017.

41. Duke u gjendur përpara të dhënave dhe shprehjeve kontradiktore, Komisioni i është drejtuar sërish me pyetje subjektit të rivlerësimit, lidhur me marrëdhënien me shoqërinë “***” sh.p.k. dhe veçanërisht me shpenzimet e punimeve të brendshme të apartamentit të përfituar prej saj, e cila, veç të tjerash ka shpjeguar se: “[...] Në lidhje me mungesën e detyrimit ndaj shoqërisë ‘***’ sh.p.k., shpjegoj se për shkak se punimet e brendshme të banesës nuk po kryeshin, por edhe afati i përfundimit të ndërtimit nuk po respektohej (afati dy vjeçar), është renë dakord verbalisht me shoqërinë sipërmarrëse ‘***’ sh.p.k., që punimet t’i kryenim me shpenzimet tona, punimet (e brendshme) të cilat do të mbulonin shumën e detyrimit të pashlyer (20.000 euro). Për të përballuar punimet e brendshme dhe mobilimin e pjesshëm të banesës, në datën 23.9.2008 kemi marrë kredi bankare në “Raiffeisen Bank” në shumën 768.255 lekë, si dhe kredi bankare pranë ‘Alpha Bank’ në datën 31.3.2009, në shumën 4.000.000 lekë. Punimet e brendshme të apartamentit 2+1 me sipërfaqe 107 m², janë kryer në periudhën tetor 2008 - nëntor 2009 [...]”.¹⁸
42. Gjithashtu, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me problematikat në analizë, subjekti i rivlerësimit është shprehur se: “Në vitin 2006, ende nuk ishte e finalizuar me kontratë marrëveshja me shoqërinë ‘***’ sh.p.k. Kjo është edhe arsyeja që këto të dhëna nuk gjenden në deklaratën e pasurisë së vitit 2006. Por, në deklaratimet e viteve 2007, 2008 dhe 2009 jam shprehur për një marrëveshje/kontratë sipërmarrje. Edhe pse kjo kontratë u formalizua ligjërisht përpara noterit në vitin 2009. Në lidhje me detyrimin e mbetur në vlerën 20.000 Euro, kontrata e sipërmarrjes ka qenë një kontratë tip e ofruar nga sipërmarrësi dhe në këtë të fundit nuk parashikohej pasqyrimi i detyrimit të mbetur, por është parashikuar shtesa e sipërfaqes që do të përfitoja me blerje duke përcaktuar sipërfaqen 50m² dhe çmimi në xokolaturë 800 euro/m²”.
43. Duke mbajtur në konsideratë sa më lart, Komisioni konstaton: (i) mospërputhje midis deklaratimeve të subjektit ndër vite dhe përmbajtjes së deklaratës “Vetting” – për sa i takon detyrimin prej 20.000 euro, të mbartur/mbetur ndaj shoqërisë “***” sh.p.k.; (ii) mospërputhje midis qëndrimit dhe pohimeve të administratorit të shoqërisë ndërtuese dhe shpjegimeve të subjektit, të dhëna përgjatë procesit të rivlerësimit, lidhur me momentin dhe mënyrën e lidhjes së marrëveshjes, zotërimin e apartamentit, kohën e kryerjes së punimeve të brendshme dhe vlerës së tyre. Gjithashtu, shpjegimet e subjektit dhe pohimet e ish-administratorit të shoqërisë rezultojnë jo bindëse dhe kontradiktore për sa kohë ato nuk përputhen as me përmbajtjen e kontratës së sipërmarrjes, të nënshkruar prej tyre në datën 16.2.2009 – nga momenti që nga njëra anë në këtë kontratë parashikohet se përfundimi i

¹⁸ Referuar faturave që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në pyetësorin nr. 2, datë 28.10.2019, rezulton se shpenzimet për rregullimin dhe mobilimin e apartamentit kanë qenë në vlerën 1.803.284,8 lekë në vitin 2008 dhe në vlerën 491.428,75 lekë në vitin 2009. Në analizën financiare janë shtuar dhe pagesa e punëtorisë për të cilën nga shpjegimet e dhëna në pyetësorin nr. 2 rezulton se nuk zotërohet faturë, si dhe shpenzimet e kryera për Chiller + falkoe (sistem ngrohës) në vlerën 7.000 euro dhe dhomë gjumi shtesë në vlerën 3.500 euro.

ndërtimit do të realizohej brenda 24 muajve, nga ana tjetër pretendohet se prej vitit 2008 – për shkak të vonesës në përfundimin e ndërtimit, palët kishin rënë dakord që kryerja e punimeve të brendshme do të bëhej me shpenzimet e subjektit të cilat do të kompensojnë detyrimin e mbetur. Në këto kushte mbetet e paqartë sa vijon: (i) për çfarë arsye subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” ka deklaruar detyrimin e mbetur prej 20.000 euro ndaj shoqërisë “***” sh.p.k. – dhe nëse ky deklaram nuk ka pasqyruar realitetin do të ishim përballë një deklarimi të rremë në deklaratën “Vetting”; (ii) përse ndryshimi i kushtit thelbësor të marrëveshjes (çmimi) nuk është bërë me shkrim, nëpërmjet një akti noterial, por vetëm verbalisht; (iii) përse kjo dakordësi verbale e vitit 2008 nuk është pasqyruar në kontratën e sipërmarrjes të lartpërmendur – për sa kohë hartimi i saj është kryer disa muaj më pas; (iv) përse nuk janë deklaruar shpenzimet e punimeve të brendshme, të pretenduara si të kryera nga subjekti i rivlerësimit në vitet 2008 dhe 2009.

44. Trupi gjykues, në konkluzion të sa më lart, i çmon shpjegimet e subjektit të paprovuara, jobindëse, kontradiktore dhe konstaton prezencën e deklarameve të interesave pasurore të subjektit si të pamjaftueshme dhe kontradiktore.

3. Lidhur me autoveturën tip “Mercedes-Benz”, me targa ***

45. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën periodike të vitit 2006, si dhe më pas në deklaratën “Vetting” e përfituar sipas kontratës nr. ***, datë 6.4.2006, që përshkruan blerjen e autoveturës tip “Mercedes-Benz”, targa ***, prodhim i vitit 1995, blerë në vlerën 8.000 euro, në emër të bashkëshortit.

46. Burimi i krijimit: shitja e mjetit në pronësi, automjet tip “Audi”¹⁹; nga kredia bankare e marrë në “Raiffeisen Bank” në datën 10.1.2006, në vlerën 500.000 lekë (kredi kjo e shlyer në vitin 2009); dhe diferenca nga të ardhurat familjare.

47. Për këtë pasuri Komisioni ka administruar dokumentacionin, si vijon:

- a. certifikatë pronësie të mjetit rrugor që vërteton regjistrimin e pronësisë për mjetin autoveturë “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 1995, me ngjyrë blu, në pronësi të bashkëshortit të subjektit, z. Dh. S.;
- b. kontratë shitblerje nr. ***, datë 6.4.2006, për blerjen e automjetit tip “Mercedez -Benz”, targa ***;
- c. veprim arke, datë 11.4.2006, për tërheqje *cash* të shumës 500.000 lekë nga z. Dh. S.;
- d. kontratë shitje automjeti nr. ***, datë 17.1.2003, me shitës A. R. dhe blerës Dh. S. për automjetin “Audi - tip 89”, me numër shasie ***, me vende 4+1, me vlerë prej 200.000 lekësh²⁰, në pronësi të bashkëshortit të subjektit. Burimi i krijimit: kursimet familjare;
- e. kontratë shitje nr. ***, datë 28.12.2005, për automjetin tip “AUDI - 80”²¹, me numër shasie ***, me ngjyrë gri, targa ***, blerësi E. B., kundrejt vlerës 200.000 lekë nga Dh. S..

¹⁹ Automjeti tip “Audi 89”, me nr. shasie ***, deklaruar në DPV-në e vitit 2003, blerë me vlerë 200.000 lekë, burimi i krijimit: të ardhurat personale të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

²⁰ Në DPV-në e vitit 2003, në f. 1, në rubrikën e formularit A-2, deklarohet se nuk ka pasuri të luajtshme, duke shënuar kutinë (jo), por deklaruar në formularin nr. 2, pasuri të paluajtshme.

²¹ Në kontratën e blerjes së këtij automjeti tip është 89.

48. Me shkresën nr. *** prot., datë 18.7.2017, DPSHTRr-ja bën me dije se z. Dh. N. S. ka në pronësi mjetin me targa ***, regjistruar në Tiranë, dosjen e mjetit, si dhe kontratën e shitjes. Informacioni i marrë përputhet me deklarinimin e subjektit.
49. Në vitin 2005 subjekti nuk e ka deklaruar shitjen e automjetit tip “Audi” dhe nuk ka deklaruar as të ardhura nga kjo shitje në rubrikën përkatëse. Ndërsa në vitin 2006 subjekti ka deklaruar shitjen e këtij mjeti me çmimin 250.000 lekë, pa e specifikuar tipin dhe nuk deklaron të ardhura nga shitja në rubrikën përkatëse.
50. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit, është shprehur se: *“Shitja e automjetit tip “Audi” është realizuar në datën 28.12.2005 dhe gabimisht është deklaruar në deklaratën e vitit 2006. Ndërsa vlera e shitjes së automjetit në deklarinimin e pasurisë së vitit 2006 është lapsus i memories.”*
51. Trupi gjykues, lidhur me këtë pasuri, konkludon se subjekti i rivlerësimit ka kryer pasaktësi në deklaratën vjetore të vitit 2006, për sa i përket vlerës së shitjes së automjetit krahasuar me çmimin e shitjes në kontratën e shitjes²², si dhe mosdeklarinimin në vitin 2005 të shitjes së automjetit tip “Audi” – të ardhurat nga kjo shitje janë deklaruar si një nga burimet e përdorura për krijimin e pasurisë së analizuar në këtë paragraf.

4. Tokë truall me sip. 3.200 m² me vendndodhje në Korçë, në bashkëpronësi të bashkëshortit të subjektit, me bashkëpronarë të tjerë, në cilësinë e trashëgimtarëve

52. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën vjetore të pasurisë të vitit 2003, në bashkëpronësi të trashëgimtarëve të të ndjerit G. S. (babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit), me 1/9 pjesë dhe me nr. regjistrimi në hipotekë ***, me nr. pasurie ***²³.
53. Ndërkohë që në deklaratën “Vetting” është deklaruar me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, njohur dhe kthyer me vendimin nr. ***, datë 12.7.2002, të KKKP-së me pjesë takuese 10/27.
54. Burimi i krijimit të kësaj pasurie, me vendimin nr. ***, datë 12.7.2002, Akti *** i KKKP-së Korçë, ku trashëgimtarët e z. N. S. përfitojnë nga pronat 1 dhe 2 sipas vendimit, secili nga ¼ pjesë, është deklaruar në vitin 2003 dhe në deklaratën “Vetting”.
55. Vërtetim hipotekor me nr. ***, datë 4.6.2003, ku z. Dh. S. ka 10/72 pjesë të pandarë, nr. pasurie ***, z. k. ***, me sip. 3200 m², plan vendosje, harta treguese, skicë pronësie²⁴.
56. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni konstatohet se me shkresën nr. *** prot., datë 12.09.2019, ASHK-ja Korçë, informon se z. Dh. S., me referencën nr. ***, datë 29.5.2003, rezulton e regjistruar kontratë dhurimi²⁵ nëpërmjet së cilës i dhuron 2/72 pjesë shtetasës F. S. dhe mbetet me 10/72 pjesë të pasurisë së mësipërme.
57. Lidhur me këtë konstatim subjekti i rivlerësimit është shprehur se: *“Në deklaratën ‘Vetting’ ka dy deklarime lidhur me këtë pasuri. Në deklarinimin e subjektit pjesa takuese është shprehur e saktë 10/72 dhe në deklarinimin e personit të lidhur (bashkëshorti) pjesa takuese*

²² Kontratë nr. ***, datë 28.12.2005, për shitjen e automjetit tip “Audi 80”, me çmim shitje 200.000 lekë.

²³ Rezulton se ka pasaktësi pasi numri i pasurisë në deklaratën “Vetting” është 9/119.

²⁴ Duket se ka pasaktësi lidhur me numrin e pasurisë.

²⁵ Kontratë dhurimi nr. ***, datë 15.5.2003, për dhurimin e sip. 88.8 m² znj. F. S..

është shënuar gabim, duke e vlerësuar si gabim njerëzor në plotësim midis dy shifrave duke ndryshuar vendin nga 10/72 në 10/27.”

58. Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me burimin e krijimit të pjesës takuese të kësaj pasurie të trashëguar, por ka rezultuar një pasaktësi në deklarimin e pjesës takuese, nga personi i lidhur, si më lart.

5. Lidhur me deklaratimet e subjektit ndër vite.

59. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2006 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron gjendje *cash* shumën 4.200.000 lekë, por nuk ka deklaruar burimin financiar të krijimit.
60. Në deklaratën e pasurisë së vitit 2007 konstatohen mospërputhje të shumëfishta të përmbajtjes së saj me gjendjen faktike të konstatuar, pasi rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer (përsëritur) të njëjtin deklaram të paraqitur më herët në vitin 2006, duke ripërshkruar shitjen e apartamentit, blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, shitjen e automjetit tip “Audi 80”; gjendjen *cash*²⁶, pagën totale të përfituara përgjatë dy viteve të ndryshëm nga vajza e subjektit, të njëjtën shumë si të paguar në favor të “Raiffeisen Bank”, si dhe detyrimin e mbetur ndaj kësaj të fundit lidhur me kredinë e marrë në vlerën 500.000 lekë. Për rrjedhojë ka rezultuar se në deklaratën e këtij viti nuk është pasqyruar e plotë situata reale ekzistuese, përgjatë dhe në fund të vitit 2007.
61. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se përgjatë këtij viti është konsumuar/zeruar gjendja *cash*.
62. Në deklaratat e pasurive për vitet 2006, 2007 dhe 2008, subjekti ka deklaruar të ardhura nga paga e vajzës në shumën 6.000 USD, për secilin vit.
63. Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me deklarimin e të ardhurave të vajzës, në pyetësin nr. 2, datë 27.9.2019, në përgjigje të të cilit ka pohuar se: *“Për periudhën shtator 2006 - qershor 2007, A. S. ka qenë e punësuar me kontratë shërbimi pranë “Fondacionit ***”, si Drejtore Projekti në Projektin “***”, i financuar nga Banka Botërore dhe i implementuar nga Fondacioni ***, përkatësisht me pagën 600 USD/muaj.”*
64. Gjithashtu, në pyetësin nr. 3, është ftuar subjekti të paraqesë dokumentacionin provues dhe të sqarojë lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga vajza e subjektit nga ky projekt, dhe në përgjigje të pyetësit në datën 29.1.2020, ka sqaruar se: *“Më lejoni të shpjegoj se përfitimet financiare për këtë periudhë janë pasqyruar jo korrekt në deklarimin vjetor të vitit 2007 (i cili i përket vitit 2006) dhe deklarimin vjetor të vitit 2008 (që i përket vitit 2007), ku e njëjta shumë e përfituar në fund të dhjetë muajve (vlera e plotë e kontratës për 10 muaj) është deklaruar dy herë, duke qenë se ky projekt është shtrirë në dy vite kalendarike, pra edhe në deklarimin e vitit 2007 edhe në deklarimin e vitit 2008. Deklarimi i saktë do të kishte qenë në deklarimin e vitit 2007, vetëm pagat që i përkasin periudhës shtator – dhjetor 2006, në vlerën 4 muaj x 600 USD/muaj, dhe në deklarimin e vitit 2008 duhej të deklaroja pagën për periudhën janar – qershor 2007, në vlerën 6x600 USD. Lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore të këtyre të ardhurave, duke u mbështetur në udhëzimin e Ministrisë të Financave për “të ardhura të tatueshme”, për mbledhjen e tatimit ngarkohet me detyrim, institucioni apo enti i cili duhet të mbajë*

²⁶ Gjendja në vlerën prej 4.200,000 lekësh.

*detyrimet tatimore në burim dhe ti derdhë ato në organin tatimor. Duke qenë se Fondacioni ***, me vendimin e bordit, datë 7.10.2009, vërtetuar me nënshkrim përpara noterit me nr. ***, datë 13.10.2009, është shpërndarë dhe është shpallur në likuidim, jam në pamundësi për t'ju vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës (bashkëlidhur vendimin e bordit drejtues të Fondacionit ***)²⁷.*”

65. Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë plotësisht bindëse, për sa kohë, përtej pranimit të gabimit material apo përlllogaritës të mosndarjes së të ardhurave të lartanalizuara në pjesët takuese të viteve 2006 dhe 2007, subjekti nuk shprehet përse edhe në deklaratën e vitit 2008, për të tretin vit radhazi, ka deklaruar një të ardhur jo reale (6.000 USD janë deklaruar tre herë). Kjo rrethanë i bën këto deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme.
66. Gjithashtu, në deklaratën e pasurisë së vitit 2008 subjekti ka deklaruar marrjen e një kredie në “Raiffeisen Bank”, në shumën prej 800.000 lekësh, ndërkohë sipas kontratës së kredisë²⁸ lidhur në datën 23.9.2008, shuma e kredisë rezulton të jetë 885.003,70 lekë. Nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar në vijim, në rubrikën e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, lidhur me kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank” në vitin 2008, ecurinë e shlyerjes të saj apo edhe detyrimin e mbetur.
67. Në deklaratën e pasurisë së vitit 2009 subjekti deklaroi kredinë e marrë në “Alpha Bank” në vlerën 4.400.000 lekë – nëpërmjet kontratës së kredisë nr. ***, datë 24.3.2009, si dhe deklaroi shlyerjen prej 756.000 lekësh dhe detyrimin prej 3.644.000 lekësh. Ndërkohë që nga deklarata, datë 27.9.2019, lëshuar nga “Alpha Bank” dhe nga lëvizjet bankare, rezulton se shuma e kredisë ka qenë 4.000.000 lekë, *disbursuar* në datën 31.3.2009 dhe jo 4.400.000 lekë sa e ka deklaruar subjekti.
68. Me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2019, lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit të ketë marrë një kredi në shumën 103.000 lekë, datë 24.9.2009,²⁹ dhe të shlyer totalisht në datën 24.3.2010. Por nuk rezulton që në deklaratën vjetore të vitit 2009 dhe 2010 subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar marrjen e kësaj kredie nga bashkëshorti, në shumën 103.000 lekë në vitin 2009 dhe as shlyerjen e saj në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010.
69. Lidhur me sa më lart subjekti i rivlerësimit është shprehur se: *“Lidhur me kredinë e marrë pranë ‘Raiffeisen Bank’, shpjegoj se me kontratën e kredisë, datë 10.4.2006, është përfituruar kredia në shumën 500.000 lekë me qëllim blerjen e automjetit ‘Mercedes – Benz’. Pa përfunduar afatin e likuidimit të kësaj shume, (shuma e mbetur rreth 85.000 lekë), datë 23.9.2008, nga kjo bankë është marrë dhe një shumë tjetër prej 800.000 lekësh. Kështu shuma e detyrimit në total ka qenë bashkimi i shumës së mbetur me shumën 800.000 lekë. Deklarimi i shumës prej 800.000 lekësh reflekton pikërisht vlerën e kredisë së re, me një lapsus për sa i përket vlerës së mbetur nga kredia e mëparshme”, si dhe: “Për sa i përket kredisë që bashkëshorti ka përfituruar në datën 20.9.2009, shpjegoj se kjo kredi është marrë*

²⁷ Referuar vërtetimit datë 25.9.2019, lëshuar nga Banka Botërore përcaktohet se Fondacioni *** është shpallur fitues për implementimin e projektit “***” dhe se znj. A. S. ka shërbyer si Drejtor Projekti dhe ka përfituruar të ardhura në masën 6.000 USD.

²⁸ Sipas kontratës së kredisë datë 23.09.2008, lidhur ndërmjet shtetasve Flutura Skënderi, Dh. S. dhe “Raiffeisen Bank”, shprehet se qëllimi i kredisë është pjesërisht për mbylljen e kredisë së akorduar me kontratën nr. 107051, datë 10.4.2006.

²⁹ Referuar kontratës së datës 20.9.2009, kredia është përdorur për blerje Laptopi dhe TV.

për blerjen një laptopi dhe një TV pranë një dyqani elektroshtëpiakesh (TRONY). Mospasqyrimi në deklaratën vjetore të saj është një haresë nga pakujdesia dhe jo me qëllim fshehjen. Burim i shlyerjes së kësaj kredie ka qenë paga e bashkëshortit nga ku në mënyrë direkt merrej kësti për këtë kredi.”

70. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën vjetore të pasurive për vitin 2010³⁰ ka deklaruar vazhdimin e shlyerjes së kredisë së marrë në “Alpha Bank” në vitin 2009, por nuk deklaroi shumën e shlyer, detyrimin e mbetur, burimin e krijimit, si dhe nuk rezultoi të ketë deklaruar në rubrikën e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank” në vitin 2008, shlyerjen e saj apo detyrimin e mbetur.³¹
71. Ndërsa në deklaratat e pasurisë së viteve 2011³², 2012, 2013, 2014 dhe 2015³³ subjekti deklaroi detyrimin e mbetur nga marrja e dy kredive, por nuk ka deklaruar shumën e shlyer, (si shpenzim), si rrjedhojë as burimin e krijimit të të ardhurave të përdorura për pagesën e këtyre kësteve.
72. Gjithashtu, subjekti në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën “Vetting” ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti privat (palestër) nga bashkëshorti, z. Dh. S., si të ardhura nga angazhimi i tij në aktivitete të tjera fitimprurëse. Nga krahasimi i deklaratave periodike dhe deklaratës “Vetting” evidentohen mospërputhje – në vitin 2005 deklarohen të ardhura nga aktiviteti privat palestër në shumën 1.200.000 lekë, kurse në deklaratën “Vetting” deklarohen si të ardhura nga ky aktivitet për të njëjtin vit vetëm në shumën 250.000 lekë.
73. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se: *“Aktiviteti privat i bashkëshortit Dh. S. në vlerën 1.200.000 lekë është bërë gabim, duke sqaruar se është një gabim material dhe se është konfunduar me nocionin e shprehjes lekë të reja me lekë të vjetra, në rastin në fjalë kam dashur të them 120.000 lekë.”*
74. Trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe shteruese, për sa kohë edhe nëse pranohej versioni i paraqitur si një gabim material – që mund t’i ndodhë çdokujt – do të rezultonte gjithsesi mospërputhja në fjalë, pasi në këtë rast shuma prej 120.000 lekësh është më pak se gjysma e shumës prej 250.000 lekësh, deklaruar në deklaratën “Vetting” si e ardhur e vitit 2005.
75. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se mbështetur në VKM-në nr. 424, datë 9.7.1998, dhe në Udhëzimin nr. 887, datë 15.3.1999, të MASH-së *“Mbi vënien në shërbim të të tretëve për palestrën e Atletikës, Fitnessit dhe Kondicionit fizik”*, në Universitetin e Sporteve Tiranë është lidhur një kontratë pune dhe shërbimi nga bashkëshorti i subjektit (me kohë të pjesshme) sipas një orari, tarife dhe numër ushtruesish në ambientet, përgjatë viteve 2001, 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2008 dhe 2009³⁴, si dhe ka vënë në dispozicion kontratat e

³⁰ Në DPV është shkruar se nuk ka ndryshim nga pasuria e vitit 2010, ndërkohë që kjo është DPV-ja e vitit 2010.

³¹ Në “Raiffeisen Bank” janë marrë 2 kredi, kredia e vitit 2006 në shumën 500.000 lekë (për të cilën deri në DPV-në e vitit 2007, rezultoi se ka ende pa shlyer shumën prej 280.000 lekësh), si dhe kredia e marrë në vitin 2008 në shumën prej 885.003.70 lekësh, për të cilën nuk deklaroi shlyerjen e saj apo detyrimin e mbetur deri në vitin 2011).

³² Përmendet kredia në “Raiffeisen Bank”, datë 10.4.2006, kredia e cila është mbyllur me marrjen e kredisë së re në “Raiffeisen Bank” në datën 23.9.2008

³³ Deklaroi shlyerjen e kredisë në “Raiffeisen Bank”.

³⁴ Kontrata e vitit 2009 lidhur ndërmjet Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve “****” dhe Personit Fizik “Dh. S.”.

punësimit të bashkëshortit³⁵. Në këto kontrata nuk përcaktohen të ardhura për z. Dh. S., të përfituara nga ky aktivitet specifik, jashtë orarit të punës.

76. Komisioni e ka ripyetur subjektin e rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 3, lidhur me të ardhurat e përfituara nga aktiviteti i marrjes në përdorim të palestrës së Universitetit të Sporteve Tiranë, duke e ftuar që të provojë me dokumentacion këto të ardhura, si dhe pagimin e detyrimeve tatimore për to. Përgjigjja e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pyetje ka qenë, si vijon: *“Mbështetur në VKM-në nr. 424, datë 9.7.1998, dhe në Udhëzimin nr. 887, datë 15.3.1999, të MASH-së “Mbi vënien në shërbim të të tretëve për palestrën e Atletikës, Fitnesit dhe Kondicionit fizik”, Universiteti i Sporteve Tiranë ka lidhur kontrata (me kohë të pjesshme) me bashkëshortin Dh. S., kontrata të cilat janë depozituar si dokumentacion mbështetës në pyetësorin proces rivlerësimi 2. Në këto kontrata janë parashikuar të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe sipas konstatimit të institucionit z. Dh. S ka plotësuar rregullisht të gjitha detyrimet ndaj institucionit. Lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore të këtyre të ardhurave, në bazë të udhëzimit të Ministrisë të Financave për “të ardhura të tatueshme”, sipas pikës 2.6 “mbledhja e tatimit”, ngarkohet me detyrim, institucioni (universiteti) i cili duhet të mbajë detyrimet tatimore në burim dhe të derdhë në organin tatimor (bashkëlidhur vërtetimi i Universitetit të Sporteve Tiranë).”*
77. Por, sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 25.9.2019, të paraqitur nga Universiteti i Sporteve Tiranë, specifikohet dhe qartësohet se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur kontratë përdorimi jashtë orarit zyrtar të punës *“Mbi vënien në përdorim të palestrës”* sipas një orari dhe tarife të përcaktuara për vitet 2001, 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2008 dhe 2009, si dhe gjatë kësaj periudhe ka derdhur rregullisht tarifën për ambientin. Konstatohet se në këtë vërtetim nuk përcaktohen as të ardhura të përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe as tatim i mbajtur në burim për këto të ardhura, por vetëm përdorimi i ambientit palestër kundrejt një pagese të kryer në favor të universitetit në fjalë.
78. Trupi gjykues, ndonëse e konsideron të provuar faktin e ekzistencës e marrëdhënies mbi zhvillimin e aktivitetit, që mendohet se ka gjeneruar të ardhura, çmon se këto të fundit nuk janë provuar as në terma sasiorë dhe as nuk rezulton që të jenë paguar tatimet përkatëse – për sa kohë të ardhurat gjeneroheshin nga aktiviteti privat dhe autonom i bashkëshortit të subjektit dhe në këtë rast universiteti nuk ka qenë në cilësinë e punëdhënësit, por të qiradhënësit të palestrës. Për rrjedhojë, këto të ardhura nën dritën e dispozitave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nuk mund të mbahen në konsideratë në analizën financiare si të ardhura të ligjshme. Njëkohësisht, trupi gjykues çmon që edhe shpenzimet përkatëse, për pagesën e qirasë në favor të universitetit – ndonëse të provuara – nuk duhet të rëndojnë në vitet përkatëse, për sa kohë logjika ekonomiko-financiare të çon në konkluzionin se, së paku, aktiviteti i kryer nga z. Dh. S., jashtë orarit të punës, duhet të ketë gjeneruar të ardhura minimalisht për kompensimin dhe balancimin e shpenzimeve të kryera, përndryshe nuk do të vijonte më tej, për shumë vite me radhë.
79. Gjithashtu, në pyetësorin nr. 3, datë 13.1.2020, subjekti është pyetur edhe lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të deklaruara si të përfituara nga kontratat e punësimit të lidhura

³⁵ Në këto kontrata përcaktohet pagesa që do të kryhet çdo muaj prej bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për marrjen në zotërim të përkohshëm të palestrës së atletikës, por nuk është paraqitur asnjë dokument lidhur me të ardhura të përfituara nga ky aktivitet nga z. Dh. S.. Rrjedhimisht, nuk mund të merren në konsideratë këto të ardhura në analizën financiare.

me klubin e futbollit të Tiranës gjatë viteve 2015 dhe 2016 – në të cilat specifikohet se sigurimet do të paguhen nga punonjësi – duke e ftuar që të paraqiste dokumentacionin provues lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga këto kontrata. Lidhur me këtë çështje, subjekti ka sqaruar se: *“Lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore të këtyre të ardhurave në bazë të udhëzimit të Ministrit të Financave ‘të ardhura të tatueshme’, sipas pikës 2.6 ‘mbledhja e tatimit’, ngarkohet me detyrim, institucioni ose enti, i cili duhet të mbajë detyrimet tatimore në burim dhe ti derdhë në organin tatimor – në rastin konkret, Klubi i Futbollit Tiranë.”*

80. Duke qenë se në këto kontrata është specifikuar që sigurimet do të paguhen nga punonjësi në shkresën datë 24.2.2019, të ISSh-së nuk rezulton që për z. Dh. S. të jenë paguar sigurime nga ky punëdhënës, atëherë edhe këto të ardhura, duke mbajtur në vëmendje përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nuk mund të konsiderohen në analizën financiare si të ardhura me burime të ligjshme, për sa kohë subjekti dhe personi i lidhur me të nuk arritën që të provojnë pagesën e detyrimeve tatimore relative.
81. Në deklaratën vjetore të pasurisë së vitit 2015, subjekti ka deklaruar se ka pasur një shtesë në vlerën e lekëve, në masën $\frac{1}{4}$ dhe $\frac{1}{4}$ pjesë e shumës prej 5.712.600 lekësh. Burimi i krijimit është deklaruar nga vendimi nr. 95, datë 30.4.2015, të AKKP-së, ku është kompensuar në të holla për sipërfaqen e njohur prej 100 m² ³⁶, ndërkohë që shuma e të ardhurave të krijuara nga vendimi i AKKP-së është $\frac{1}{15}$ pjesë të vlerës, në masën 350.000 lekë³⁷.
82. Komisioni konstaton pasaktësi të shumëfishta në deklaratimet e pasurive dhe të kredive bankare, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit ndër vite, si dhe pamjaftueshmëri për sa i përket shumave të deklaruara si të ardhura të realizuara nga z. Dh. S., të përshkruara më lart, për të cilat nuk u provua pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse.

6. Lidhur me deklarimin e gjendjes *cash* në deklaratën “Vetting”, në shumën prej 10.000 euro

83. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 10.000 euro, me burime nga të ardhurat familjare, ndërsa në deklaratën vjetore të pasurisë të vitit 2017, subjekti ka deklaruar dhe specifikuar se gjendja *cash*, jashtë sistemit bankar është pakësuar nga 10.000 euro në 8.500 euro (për shpenzime familjare).
84. Ndërkohë nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar gjendje *cash* në deklaratën e vitit 2016. Duke konsideruar faktin se subjekti i rivlerësimit në vitin 2008 kishte deklaruar shprehimisht përdorimin total, zerimin, e shumave të deklaruara më herët në gjendje *cash*, dhe nga viti 2009 deri në vitin 2016 nuk është deklaruar zotërim në gjendje *cash*. Lidhur me këtë rrethanë të veçantë, Komisioni vlerëson se nga njëra anë kemi të bëjmë me një deklaram mbi një gjendje *cash* në deklaratën “Vetting”³⁸ të pambështetur në prova dhe mundësi reale financiare për të gjeneruar këto kursime në gjendje *cash* pas datës 31.12.2016 dhe nga ana tjetër ky deklaram i gjendjes *cash* nuk konfirmohet as nga deklaratimet e subjektit

³⁶ Referuar vendimit të AKKP-së, prokura e posaçme i është deleguar z. E. R. për tërheqjen e shumës monetare, si dhe në DPV është shkruar në f. 3, pas numrit 100 m² “mijë e gjashtëqind”.

³⁷ Ka mospërputhje midis masës së përfitimit nga $\frac{1}{4}$ e $\frac{1}{4}$ ($\frac{1}{16}$) në $\frac{1}{15}$.

³⁸ Dorëzuar nga subjekti në datën 26.1.2017.

të paraqitura nëpërmjet deklaratës vjetore të vitit 2016³⁹ – të paraqitur rreth një muaj pas deklaratës “Vetting” – subjekti nuk deklaroi që të ketë disponuar gjendje *cash* në datën 31.12.2016. Për rrjedhojë, kjo shumë mund të konsiderohet si e gjeneruar vetëm nga të ardhurat e realizuara gjatë periudhës 1– 26.1.2017.

85. Në deklaratën vjetore të vitit 2017, subjekti ka deklaruar pakësimin e gjendjesh *cash* nga 10.000 euro në 8.500 euro, si dhe shtimin e gjendjes *cash* në lekë me vlerën 410.234 lekë, burimi i krijimit të të cilave është deklaruar nga të ardhurat e bashkëshortit nga orët jashtë orarit dhe udhëheqje shkencore.
86. Pasi është njohur me rezultatet e përcjella nga Komisioni, lidhur me këtë pikë, subjekti i rivlerësimit është shprehur se kursimet në gjendjen *cash* prej 10.000 euro, janë të grumbulluara në periudhën 2012 – 2017 dhe ka renditur disa zëra të ardhurash kryesisht nga aktiviteti i bashkëshortit jashtë orarit të punës, të deklaruara në vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, shumatorja e të cilave së bashku me vlerën prej 350.000 lekësh, të përfituar nga vendimi nr. 95, datë 30.4.2015, i AKKP-së – sipas saj – kishte gjeneruar shumën *cash* në fjalë.
87. Trupi gjykues, duke konsideruar faktin që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndonjë kursim në gjendje *cash*, në periudhën 2009 – 2016, çmon se shpjegimet e saj janë jobindëse. Nisur ka ky fakt, si dhe duke mbajtur në vëmendje që edhe burimet e cituara, ndër vite, nga subjekti kanë rezultuar të paprovuara në kuptimin e burimit të ligjshëm sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, konkludohet se subjekti ka bërë deklarime kontradiktore dhe të pasakta lidhur me zotërimin e gjendjes *cash*, si dhe nuk ka pasur burime financiare të ligjshme që të realizojë dhe disponojë këto kursime në gjendje *cash*, në momentin e kryerjes së deklaratës “Vetting”.

7. Lidhur me shpenzimet e shkollimit për vajzën e subjektit të rivlerësimit, znj. A. S.

88. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se vajza e subjektit të rivlerësimit, znj. A. S., ka ndjekur studimet universitare në “***”, në Maltë. Sipas vërtetimit lëshuar nga universiteti në datën 28.3.2019, znj. A. S., ka ndjekur studimet në këtë universitet gjatë periudhës tetor 2000 – shtator 2004 dhe se është përjashtuar nga pagesa e tarifës nga Ministria e Arsimit.
89. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, datë 21.9.2019, subjekti lidhur me detajet mbi pagesat për shkollimin dhe shpenzimet e jetesës shpenzimet e jetesës, ka shpjeguar, si vijon: *“Shpenzimet e jetesës janë mbuluar me të ardhura familjare në shumën 90 paund maltez/muaj (MLT), ku qiraja mujore e apartamentit ka qenë 180 MLT, e cila është ndarë midis tre studenteve (60 MLT secili student/muaj), ushqimi në kuotën 30 MLT/muaj dhe shpenzime për libra/fotokopje (gjithësej 2 herë në vit) nga 25 MLT.”*
90. Lidhur me këto shpenzime, Komisioni ka kryer kërkime në faqen zyrtare të National Statistics Office – Malta⁴⁰ për statistikat lidhur me shpenzimet e jetesës në Maltë gjatë kësaj periudhe. Nga analiza e bërë në anketën buxhetore familjare për vitin 2000⁴¹, rezulton se

³⁹ Dorëzuar nga subjekti në datën 24.2.2017.

⁴⁰ Zyra Kombëtare e Statistikave – Maltë (vvvvvv.nso.gov.mt).

⁴¹https://nso.gov.mt/en/publicatons/Publications_by_Unit/Documents/01_Methodology_and_Research/HBS2000.pdf, fq 156

shpenzimet vjetore mesatare për një person shkojnë 4.821,8 MLT⁴², duke konsideruar se këto shpenzime janë një mesatare për të gjithë popullsinë, ku vajza e subjektit ka qenë studente (jetesa studentore mund të prezumohet me shpenzime më të ulët jetese) dhe shpenzimet e jetesës për këtë periudhë janë konsideruar në masën 50 % të shpenzimeve mesatare⁴³.

91. Gjithashtu, në periudhën shtator 2004 – nëntor 2005, vajza e subjektit ka ndjekur studimet *Master* për studime diplomatike në Universitetin Westminster, Londër. Sipas vërtetimit datë 13.3.2019 të lëshuar nga ky universitet, tarifa e shkollimit për këtë vit akademik paguar nga znj. A. S., ka qenë 8.230 GBP dhe lidhur me këtë periudhë studimesh, subjekti ka pohuar se: *“Qiraja mujore e apartamentit ka qenë 800 MLT, e cila është ndarë midis dy studentëve (400 GBP secili student/muaj). Ushqimi në kuotën 45 GBP/muaj. Shpenzime për libra/fotokopje (gjithësej 2 herë në vit) nga 25 GBP. Shpenzimet për studimin dhe jetesën janë mbuluar nga familja e cila në datën 1.10. 2004 ka lidhur një kontratë kredie bankare në ‘Alpha Bank’ në shumën 18.000 euro.”* Subjekti, në këtë pyetësor, ka shtuar se: *“Gjatë periudhës (afërsisht) janar – qershor 2005 A. ka punuar pranë dyqanit ***, dega Marble Arch duke përfutur një pagë mujore prej 400 GBP.”*⁴⁴
92. Lidhur me këto shpenzime, Komisioni ka kryer kërkime në faqen zyrtare të Zyrës Kombëtare të Statistikave për statistikën lidhur me shpenzimet e jetesës në Mbretërinë e Bashkuar⁴⁵ gjatë kësaj periudhe dhe nga analiza e kryer nga ky institucion ka rezultuar se për periudhën 2004 – 2006 shpenzimet javore/person kanë qenë përkatësisht 182 GBP, 188 GBP dhe 192,80 GBP. Komisioni i ka marrë në konsideratë këto shpenzime gjatë kryerjes së analizës financiare, duke konsideruar qiranë mujore prej 100 GBP/javë (bazuar në deklarin e subjektit) dhe 80 GBP/javë për shpenzimet e tjera të jetesës.
93. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit, subjekti ka dhënë shpjegime të tjera, si dhe ka paraqitur deklaratë të një personi që kishte ndarë shpenzimet e qirasë dhe të jetesës me vajzën A. S., përgjatë të dyja periudhave studimore të lartpërmendura. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti është shprehur se ishte dakord me përlllogaritjen e kryer nga Komisioni lidhur me shpenzimet e studimeve të vajzës jashtë shtetit, si dhe që hetimi administrativ i kryer, në përgjithësi, kishte qenë objektiv dhe gjithëpërfshirës.
94. Konkretisht, znj. L. K. B., në deklaratën noteriale, datë 18.5.2020, në Sofie, Bullgari, ka deklaruar se gjatë viteve 2000 – 2004 ka ndjekur studimet në Maltë, së bashku me vajzën e subjektit të rivlerësimit, znj. A. S., me të cilën ka ndarë apartamentin, shpenzimet për akomodimin dhe për koston e jetesës, të cilat shkonin 45 MTL/javë për qiranë dhe 23 MTL/javë për jetesën. Në këtë deklaratë, shtetasja në fjalë, ka deklaruar gjithashtu se pas studimeve në Maltë, së bashku me vajzën e subjektit të rivlerësimit, kanë ndjekur studimet

⁴² 1 lirë maltese është konvertuar me 2.4581 euro sipas kursit zyrtar të datës 29.12.2000, të publikuar në faqen zyrtare www.centralbankmalta.org

⁴³ Duke rezultuar në masën 201 lira malteze/muaj (ekuivalenti prej 493.8 euro/muaj shpenzime totale).

⁴⁴ Subjekti ka bashkëlidhur në pyetësorin nr. 1 e-mail-in e komunikimit me departamentin e burimeve njerëzore të kompanisë River Island kur është kërkuar konfirmimi i këtyre të dhënave. Sipas politikës së saj, kompania është shprehur se është e gatshme të vërë në dispozicion të dhënat e kërkuara vetëm me kërkesë të drejtpërdrejtë nga institucioni kërkues ose nëse i vihet në dispozicion adresa elektronike e institucionit kërkues nëpërmjet një komunikimi të drejtpërdrejtë institucional.

⁴⁵Faqja zyrtare e Office of National Statistics United Kingdom www.ons.gov.uk dhe dokumenti është publikuar në faqen: <https://vvebarchive.nationalarchives.gov.uk/20170804160236/http://vvebarchive.nationalarchives.gov.uk/20160105160709/http://www.ons.gov.uk/ons/rel/family-spending/family-spending/2015-edition/rft-4-3.xls>.

edhe në Londër, Mbretëri e Bashkuar, ku kanë ndarë sërish apartamentin dhe shpenzimet e jetesës, përkatësisht 200 GBP/javë për qiranë dhe zakonisht 22.5 GBP/javë për jetesën. Deklaratës në fjalë i janë bashkëlidhur edhe kopjet e diplomave të shtetases L. K. B. nga Universiteti i Maltës dhe Universiteti në Londër.

95. Në bazë të analizës financiare, të kryer nga njësia e shërbimit ligjor, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi që të përballonte me burime të ligjshme financiare totalisht shpenzimet e shkollimit së bashku me investimet dhe shpenzimet e tjera, tw kryera pwrgrjatë viteve 2003, 2005 dhe 2006, pasi janë konstatuar disa mangësi që janë përfshirw nw rezultatin final tw bilanceve respektive.

8. Lidhur me analizën financiare

96. Në vijim të analizës financiare të kryer nga njësia e shërbimit ligjor të Komisionit, mbi deklaratimet periodike ndër vite, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2003, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti në ILDKPKI, nga ku, fillimisht ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në vlerën **2.898.097 lekë**, i cili i është njoftuar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

97. Pasi është njohur me rezultatet e analizës financiare, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur ka kërkuar që të përlllogariten shpenzime jetike më të ulëta për periudhën e studimeve së znj. A. S. jashtë shtetit – në përputhje me dokumentacionin provues të paraqitur, si dhe të pasqyroheshin të ardhura shtesë në analizën financiare dhe konkretisht lidhur me: (i) të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti jashtë orarit të punës, i zhvilluar në palestrën e Universitetit të Sporteve Tiranë – ashtu siç janë përlllogaritur shpenzimet e qirasë për përdorimin e këtij objekti; (ii) të ardhurat nga marrëdhënia e punës së bashkëshortit të subjektit me “Tirana futboll klub”; (iii) vitin 2016 të konsideroheshin të ardhurat e gjeneruara nga kontrata e konsulencës së vajzës A. S. me Këshillin e Evropës, datë 1.7.2016, me vlerë 1.500 euro (202.905 lekë), për të cilën ka informuar se janë paguar detyrimet tatimore dhe për këtë subjekti është shprehur se: *“Lidhur me pagesën tatimore për vlerën e përfituar nga kontrata e konsulencës me KiE, A. S. me cilësinë e individit ka ndërmarrë iniciativën për ta paguar tatimin pranë DPT-së në vitin 2016, por nga nëpunësit e këtij institucioni i është shpjeguar se institucioni për shkak të praktikave të paqëndrueshme, do të fillojë të merret me shqyrtimin e këtyre rasteve pas daljes së akteve nënligjore nga DTP-ja dhe do të njoftohet të përmbushet detyrimin tatimor. Në datën 19.5.2020, znj. A. S., ka paguar detyrimin tatimor për vlerën e kontratës së konsulencës në vlerën 6,000 euro.”*

Vlerësimi i trupit gjykues

98. Trupi gjykues ka analizuar të gjitha pretendimet e subjektit dhe ka marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat për të cilat është provuar burimi i ligjshëm në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr. 84/2016. Çdo pretendim i subjektit gjen qëndrimin respektiv të trupit gjykues të argumentuar në paragrafët përkatës ku janë trajtuar tematikat specifike. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga znj. A. S. në vitin 2016, specifikohet fakti që ato në çdo rast nuk do të prodhonin asnjë efekt përcaktues apo ndikues lidhur me mungesat e burimeve të rezultuara nga analiza financiare, për sa kohë bilanci i vitit 2016 edhe pa i konsideruar të ardhurat shtesë në vlerën prej 1.500 euro, rezulton pozitiv. Për rrjedhojë, duke marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat e dokumentuara me burime të ligjshme, duke e konsideruar përfitimin e të gjithë çmimit të shitjes së apartamentit prej 5.000.000 lekësh, sipas përmbajtjes së kontratës përkatëse, në vitin 2006, duke pranuar versionin e subjektit të rivlerësimit lidhur me shpenzimet e znj. A. S. për studime jashtë shtetit, si dhe duke zbritur nga shpenzimet e përlogaritura pagesat e kryera nga z. Dh. S., për qiramarrjen e palestrës së Universitetit të Sporteve të Tiranës, rezulton një bilanc i përgjithshëm negativ, me një total prej – 1.800.083 lekësh, mungesë financiare kjo e përqendruar në vitet 2005 dhe 2006.
99. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se për sa i takon kriterit të pasurisë, bazuar në analizën financiare të kryer nga njësia e shërbimit ligjor, subjekti i rivlerësimit, znj. Flutura Skënderi, nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme, sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për të kryer të gjitha investimet e konstatuara dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet, apo për të realizuar kursimet e deklaruar, për rrjedhojë – duke përfshirë dhe përthithur këtu edhe problematikat që kanë rezultuar mbi deklarimin e gjendjes *cash* prej 10.000 euro në deklaratën “Vetting”, si dhe mbi deklarimet e pamjaftueshme të pasurive, pa qenë nevoja për t’u ndalur në argumentime specifike për secilën prej tyre – trupi gjykues çmon se në këtë rast duhet të aplikohet pika 3, e nenit 61, e ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

100. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë në Komisionin raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit në të cilin i është konstatuar *përshatshmëria e subjektit të rivlerësimit, znj. Flutura Skënderi*.
101. Me shkresën e datës 22.5.2019, DSIK-ja i ka komunikuar Komisionit se nga organet ligjzbatuese nuk ka pasur informacione të mëtejshme lidhur me figurën e këtij subjekti.
102. Me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2019, DSIK-ja i ka komunikuar Komisionit se raportin i sipërcituar është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 4.10.2019, të KDZH-së. Në vijim të sa më lart, Komisionit nuk i kanë rezultuar informacione apo fakte të reja lidhur me këtë kriter.

103. Në këto kushte trupi gjykes e vlerëson të përshtatshëm subjektin e rivlerësimit, znj. Flutura Skënderi, për sa i përket kriterit të figurës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

C/1 VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KLGJ-ja

104. Komisioni, në bazë të neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/206, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin bashkëngjitur – ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.
105. Lidhur me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti vërehet se paraqiten të standardizuar në drejtim të organizimit formal dhe të strukturës, duke përdorur thujtje të njëjtën strukturë në hartimin e tyre.
106. Nga shqyrtimi i pesë dosjeve të përzgjedhura në mënyrë rastësore, veç vlerësimeve përgjithësisht pozitive, KLGJ-ja ka konstatuar, sa vijon:
- a. Në dosje nuk ka akte që tregojnë caktimin e seancës së parë gjyqësore.
 - b. Në dosje nuk ka të dhëna për komunikimet apo kërkimet e akteve apo provave me shkresa drejtuar institucioneve të treta.
 - c. Në procesverbal është dokumentuar relatimi i subjektit të rivlerësimit, por nuk është pasqyruar baza ligjore (neni 464 i Kodit të Procedurës Civile).
 - d. Në dispozitiv nuk disponohet për të drejtën e rekursit dhe për shpenzimet gjyqësore, duke mos plotësuar të gjitha elementët e kërkuara nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile.
 - e. Në një rast në dispozitiv nuk disponohet sipas nenit 420/3 të Kodit të Procedurës Penale, lidhur me njoftimin e vendimit të mospranimit të ankimit, duke qenë se i pandehur nuk ka qenë prezent dhe as i përfaqësuar në seancën gjyqësore.
 - f. Në dispozitiv nuk disponohet për të drejtën e rekursit sipas nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale.
 - g. Përgjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Flutura Skënderi janë paraqitur 10 ankesa, nga të cilat 6 janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar: për 1 ankesë të vitit 2014 është verifikuar se nuk ka pasur shkelje nga subjekti për mosrespektim formal të ligjit; 2 ankesa të vitit 2014, verifikuar për zvarritje gjykimi, i janë regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik; 1 ankesë e vitit 2016, verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, si dhe mbajtja në vijim deri në përfundim të gjykimit në Gjykatën e Lartë.
107. Pas kërkimit të informacionit nga Komisioni, KLGJ-ja ka informuar se përgjatë periudhës së rivlerësimit për gjyqtaren Flutura Skënderi nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

C/2 VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

Lidhur me rrethanat e dy gjykimeve në konflikt interesi

108. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni kreu hetime lidhur me personat me të cilët subjekti i rivlerësimit kishte pasur marrëdhënie interesi, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit

Tiranë me shkresën e datës 24.7.2019, mbi rastet e mundshme të ekzistencës së konfliktit të interesit, në çështjet gjyqësore ku subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e trupit gjykues.

109. Veç të tjerash nga shkresa e Gjykatës së Apelit Tiranë, datë 29.7.2019, ka rezultuar se në një çështje gjyqësore, ku si palë ndërgjyqëse ka qenë shoqëria “****” sh.p.k., subjekti e ka shqyrtuar dhe është shprehur me vendimin nr. ***, datë 16.10.2015.
110. Gjithashtu, ka rezultuar se Gjykata e Apelit Tiranë me një trupë, ku sërish kishte si anëtare edhe gjyqtaren Flutura Skënderi, ka shqyrtuar një tjetër çështje me palë ndërgjyqëse shoqërinë “****” sh.p.k., me administrator A. A. Në këtë rast, konstatohet se Gjykata e Apelit Tiranë është shprehur me vendimin nr. ***, datë 12.02.2014.
111. Duke pasur parasysh faktin që subjekti i rivlerësimit ka një marrëdhënie civilo-tregtare të lidhur me kontratën e porosisë të vitit 2009 dhe ka pasur detyrim të mbartur edhe në vitet kur janë shqyrtuar çështjet e lartpërmendura – për sa kohë ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se kishte ende një detyrim financiar në vlerën prej 20.000 euro ndaj kësaj shoqërie – subjektit i janë njoftuar rezultatet, ku Komisioni lidhur me këtë rrethanë, në konkluzion – shprehet se duket se znj. Flutura Skënderi ka shqyrtuar dhe gjykuar dy çështje gjyqësore në prezencën e konfliktit të interesit duke qenë se subjekti i rivlerësimit gjendej në një marrëdhënie interesi me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe me administratorin e saj, që rezultonte edhe si dorëzanës⁴⁶ në një kredimarrje në favor të znj. Flutura Skënderi, duke e ftuar këtë të fundit që të paraqitë shpjegimet dhe provat përkatëse.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

112. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit, lidhur me këto rrethana, është shprehur, si më poshtë vijon:

*“Në çështjet gjyqësore me palë ndërgjyqëse shoqërinë ‘***’ sh.p.k., me administrator A. A., ndërhyrës kryesor shoqëria ndërtuese ‘****’ sh.p.k., me objekt padie për paditësin: “kthim sendi” dhe sigurim padie, si dhe me objekt padie të ndërhyrësit kryesor shoqërisë ‘****’ sh.p.k.: ‘Përmbushje detyrimi kontraktual, pagimi i çmimit të mallrave të blera nga pala paditëse në shumën 93.166 euro dhe kamatëvonesa” trupi gjykues ku kam qenë në përbërje te tij ka shqyrtuar këtë çështje dhe me vendimin nr. ***, datë 16.10.2015, është vendosur “lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 6.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për sa i takon pranimin të padisë së paditësit A. A. dhe ndërhyrësit kryesor, shoqëria ‘****’ sh.p.k., si dhe në çështjen, ku jam shprehur me vendimin nr. ***, datë 12.02.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjithashtu, kam qenë edhe pjesë e trupës gjyqësore në dhënien e vendimit nr. ***, datë 12.2.2014, të Gjykatës së Apelit Tirane, si dhe ka shpallur moskompetencën lëndore, pa gjykuar themelin e konfliktit midis palëve”.*

⁴⁶ Kontratën nr. ***, datë 24.3.2009, të lidhur midis “Alpha Bank” dhe kredimarrësve Dh. dhe Flutura Skënderi, si dhe me cilësinë e dorëzanës kundrejt bankës shoqëria “****” sh.p.k., person juridik përfaqësuar nga administratori i saj, z. A. A., për marrjen e kredisë në shumën 4,400,000 lekë, si dhe deklaratën nr. ***, datë 5.10.2016 nga “Alpha Bank”. Nga analiza financiare, konstatohet se deri në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka ende të pashlyer kredinë e marrë në “Alpha Bank”, në shumën e mbetur 1.287,996 lekë, në këtë kuptim marrëdhënia e dorëzarisë me subjektin “****” sh.p.k., ende nuk është shuar, pasi referuar nenit 597 të Kodit Civil: “dorëzania shuhet me shuarjen e detyrimit kryesor”.

Vlerësimi i trupit gjykues

113. Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e depozituara në datën 3.6.2020 me nr. *** prot., dhe datë 5.6.2020 me nr. *** prot., ka depozituar edhe kontratën nr. ***, datë 24.3.2009, të lidhur midis “Alpha Bank” dhe kredimarrësve Dh. dhe Flutura Skënderi, si dhe me cilësinë e dorëzanesit kundrejt bankës shoqëria “****” sh.p.k., person juridik përfaqësuar nga administratori A. A., për marrjen e kredisë në shumën 4.400.000 lekë, si dhe deklaratën nr. ***, datë 5.10.2016, nga “Alpha Bank”.
114. Trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë dispozitat e nenit 3, të ligjit nr. 9367, datë 9.2.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” ndryshuar me ligjin nr. 9473, datë 9.2.2006, ndryshuar me ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, ligjin nr. 86, datë 18.9.2012, ligji nr. 44, datë 24.4.2004, neni 5, pika 1, germa “b”, “c”, “dh”, si dhe 10 parime bazë të Rezolutës “Parimet e Paanësisë” miratuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, nga ku rezulton se nocioni i konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit, në të cilën ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta që ndikojnë, mund të ndikojnë, ose duket sikur ndikojnë në kryerjen e padrejtë të të drejtave dhe përgjegjësisive publike, vlerëson se marrëdhënia e interesit ekzistuese midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., ngre dyshime të arsyeshme se mund të ndikonte/ose ka ndikuar në detyrën publike të ushtruar nga subjekti i rivlerësimit, për më tepër që ka qenë në një marrëdhënie të dyfishtë: nga njëra anë një marrëdhënie tregtare shkëmbim dhe shitblerje, me një detyrim të mbartur, të deklaruar në deklaratën “Vetting” (më pas të pretenduar si të shuar me akord verbal) dhe nga ana tjetër ekzistenca e një përfshirjeje të shoqërisë në dorëzani të një kredie ende të papërfunduar, me kredihënësin “Alpha Bank” dhe dorëzanesin, garantuesin e kredisë, shoqërinë “****” sh.p.k.
115. Gjendja e konfliktit të interesit duhet të ekzistojë në kohën e gjykimit të çështjes (2 çështjet janë shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2014 dhe në vitin 2016), kur palët realisht duhet të ndihen/ndiheshin në kushtet e kërimit të interesave reciproke, apo mundësisë së rënies në të ardhmen në konflikt interesi për shkak të përfitimeve në të ardhmen të secilës palë. Por në rastin konkret, duke qenë se në vitet 2014 dhe 2016, nuk ishte shlyer ende as detyrimi financiar ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. – sipas deklaratës “Vetting” – dhe as kredia në “Alpha Bank”, ekzistonin detyrimet e ndërsjella mes palëve – ato ende nuk ishin shuar – çka ka bërë të mundur ekzistencën e marrëdhënieve të interesit midis palëve, të drejtat dhe detyrimet.
116. Nga kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se të dhënat e nxjerra nga disa prej dosjeve të administruara nga Komisioni, përfshirë këtu edhe denoncimet nga publiku, janë konstatuar problematika të një niveli të tillë që vlerësohet se nuk përbëjnë në vetvete shkaqe të mjaftueshme për të konkluduar për papërshtatshmërinë profesionale të znj. Flutura Skënderi, pasi trupi gjykues çmon se ka arritur/ arrin së paku, nivel minimal kualifikues të kriterit profesional, të parashikuar dhe kërkuar nga germa “c”, e nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i. Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme – sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës – për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet apo për të

realizuar kursimet e deklaruara. Gjithashtu subjekti ka kryer disa deklarime të pamjaftueshme. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e deklaramit të pasurisë dhe në këtë rast duhet aplikuar pika 5, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 3, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

ii. Në lidhje me kontrollin e figurës, subjekti i rivlerësimit arrin një nivel të besueshëm, sipas germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, dhe trupi gjykues e konsideron të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

iii. Në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit janë konstatuar disa problematika që në vetvete çmohen të pamjaftueshme për të konsideruar subjektin nën nivelin minimal të përcaktuar nga dispozitat ligjore dhe, për rrjedhojë, konsiderohet se znj. Flutura Skënderi ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

117. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në provat që zotëron, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjektit të rivlerësimit, znj. Flutura Skënderi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë duhet t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Flutura Skënderi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 23.7.2020.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Pamela QIRKO

Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Relator

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Anisa Duka
Sekretare gjyqësore